



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCEDURA PËR VLERËSIMIN E KRITEREVE TË ZOTËSISË JURIDIKE PËR FITIMIN E SË DREJTËS SË VOTËS

VOTIMI JASHTË KOSOVËS

I. Baza ligjore për nxjerrjen e Procedurës për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në pajtim me nenin 64.2, nenin 128 dhe nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nxjerr procedurën për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës.

Kjo procedurë ka për qëllim që të përcaktoj të gjitha hapat për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për qytetarët që janë të regjistruar si shtetas në Regjistrin Qendror Civil të Republikës së Kosovës dhe për personat të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, me kusht që t'i plotësojnë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Procedura për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës bazohet në dokumentet ligjore që përbëjnë bazë për fitimin e shtetësisë, të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Dokumentet bazë për hartimin e Procedurës për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës, janë:

1. Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,
2. Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës,
3. Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2000/ 13 mbi Zyrën Qendrore të Gjendjes Civil (që është në fuqi sipas Ligjit për Shtetësi),
4. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 04/2014 Për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës, dhe
5. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2014 për Kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish – RFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës me 1 janar 1998.

II. Kriteret e zotësisë juridike

Për të votuar në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021, Ju duhet të aplikoni për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, në mënyrë që të përfshiheni në Listën e Votuesve jashtë Kosovës dhe të dëshmoni se i plotësoni disa kushte.

Nëse jeni aplikues i ri, duhet të siguroni fotokopje të dokumenteve mbështetëse me të cilat dëshmohet kërkesa juaj për regjistrim (siç cekën më poshtë).

SHËNIM: Nëse jeni regjistruar më parë për të votuar përmes postës në zgjedhjet e fundit, ose jeni të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, si shtetas i Republikës së Kosovës, Ju keni dëshmuar kriteret e zotësisë juridike për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës 2021. Për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës, kriteret që duhet të dëshmohen janë:

1. Identiteti juaj,
2. Mosha juaj,
3. Të keni kryer regjistrimin civil në Republikën e Kosovës, OSE
4. Të keni qenë banorë i Kosovës më 1 janar 1998 DHE
5. T'i plotësoni disa kriteret e zotësisë juridike civile.

1. IDENTITETI JUAJ

Për të dëshmuar identitetin tuaj, Ju duhet të dërgoni një dokument të vlefshëm zyrtar me fotografinë tuaj.

SHEMBULL: Dokumenti i vlefshëm i identifikimit, Pasaportë valide, Dokument i vlefshëm i udhëtimit, Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, Kartela e vlefshme e PZHBV-ve dhe Kartela e vlefshme e refugjatit.

DHE

2. MOSHA JUAJ

Duhet t'i keni mbushur së paku 18 vjet deri më 17 Tetor 2021. Për të dëshmuar moshën tuaj, dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar në të cilin tregohet data e lindjes suaj.

Fotografia nuk është e domosdoshme.

SHEMBULL: Dokumenti i vlefshëm i identifikimit, Pasaportë valide, Dokument i vlefshëm i udhëtimit, Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, Kartela e vlefshme e PZHBV-ve, Kartela e vlefshme e refugjatit ose certifikatën e lindjes, librezën e shëndetësisë, kartelën e anëtarësisë në shoqatë, etj.

DHE QOFTË SE

3. TË KENI KRYER REGJISTRIMIN CIVIL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Nëse jeni shtetas i Republikës së Kosovës, i regjistruar në Regjistrin Civil, ju mund ta dëshmoni këtë sipas pikave 1 dhe 2, ju keni zotësi juridike për të votuar.

Nëse nuk jeni i regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës, duhet të dëshmoni sipas pikave 1 dhe 2, dhe pikave 4 dhe 5, si më poshtë.

OSE

4. TË KENI PASUR VENDBANIM NË KOSOVË MË 1 JANAR 1998

Për të dëshmuar vendbanimin tuaj në Kosovë më 1 janar 1998, fotokopja e një dokumenti zyrtar të lëshuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku pesë (5) vjetësh para datës 10 qershor 1999, do të pranohet si dëshmi. Dokumenti duhet të tregojë qartë datën kur dhe vendin ku është lëshuar, emrin dhe mbiemrin tuaj (ose nëse keni qenë fëmijë i varur, emrin dhe mbiemrin e njërit prind. Në këto raste luteni të siguroni dokumentacion me të cilin dëshmohet lidhja juaj familjare me prindin tuaj, për shembull certifikata e lindjes, etj.) Fotografia nuk është e domosdoshme.

SHEMBULL: Libreza e shëndetësisë, libreza e shkollës ose fatura e shërbimeve komunale të dërguara në adresën tuaj në Kosovë gjatë kësaj periudhe, çdo dokument tjetër më adresën tuaj dhe me datë, ose dokumentet zyrtare të refugjatëve që tregojnë largimin tuaj nga Kosova ose arritjen në vendin nikoqir.

SHËNIM: Nëse jeni larguar nga Kosova para datës 1 janar 1998 dhe nëse ju kanë njohur zyrtarisht si refugjat më 1 janar 1995 ose pas kësaj date, siç përcaktohet me Konventën e vitit 1951 përkitazi me statusin e refugjatëve, ju liroheni nga kërkesa e vendbanimit e datës 1 janar 1998. Kur të aplikoni, luteni të dërgoni dëshmi për statusin tuaj.

Nëse nuk mund të dëshmoni statusin e refugjatit dhe jeni larguar nga Kosova para datës 1 janar 1998, ju nuk keni zotësi juridike të votoni përmes postës.

SHEMBULL: Dokumenti zyrtar nga vendi nikoqir me të cilin vërtetohet statusi i juaj i refugjatit.

DHE

5. TË MUND TA DËSHMONI CILINDO NGA KRITERET VIJUESE:

a) Të jeni lindur në Kosovë

Dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar në të cilin tregohet se jeni lindur në Kosovë para 1 janarit 1998 dhe dokumentet që janë lëshuar nga Republika e Kosovës, me të cilat dëshkohet se keni lindur në Kosovë.

SHEMBULL: Pasaporta e lëshuar nga Republika e Kosovës/ UNMIK-u, Letërnjoftimi i lëshuar nga Republika e Kosovës/ UNMIK-u, Certifikata e lindjes dhe certifikata e martesës e lëshuar nga Republika e Kosovës/ UNMIK-u, Certifikata e shtetësisë së ish – RFJ-së, Certifikata e lindjes e ish – RFJ-së, Certifikata e martesës e ish – RFJ-së, Pasaporta e lëshuar nga ish-RFJ dhe Letërnjoftimi i ish – RFJ-së, librezat e shkollës, librezat e shëndetësisë, dokumenti i ushtrisë, etj., të cilat janë lëshuar para datës 10 qershor 1999.

OSE

b) Të keni njërin prind të lindur në Kosovë

Nëse njëri ose të dy prindërit tuaj janë lindur në Kosovë, ju mund të keni zotësi juridike për të votuar. Për të dëshmuar zotësinë tuaj juridike, luteni të dërgoni fotokopjen e dokumentit zyrtar me të cilin dëshkohet se prindi juaj ka lindur në Kosovë (si në pikën 5, a) dhe po ashtu dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar në të cilin tregohet lidhja juaj familjare me prindin tuaj.

SHEMBULL: Letërnjoftimi i lëshuar nga ish-RFJ, certifikata e lindjes, etj.

OSE

c) Të keni jetuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku pesë (5) vite radhazi

Për të dëshmuar se keni jetuar në Kosovë së paku gjatë pesë viteve vijuese, luteni të dërgoni fotokopjen e së paku dy, e preferohet tri dokumente zyrtare të lëshuara në Kosovë. Këto dokumente duhet të kenë data dhe të përfshijnë adresën tuaj (nëse ka mundësi) dhe së bashku duhet të përfshijnë së paku periudhën prej pesë vjetësh. Fotografia nuk është e domosdoshme.

SHEMBULL: Fatura e shërbimeve komunale ose korrespondenca zyrtare në adresën tuaj në Kosovë, librezat e shkollës, librezat e shëndetësisë, librezat e punësimit, etj.

OSE

d) Të jeni detyruar të largoheni nga Kosova prandaj nuk keni pasur mundësi të banoni në Kosovë gjatë një periudhe vijuese prej pesë vjetësh

Nëse jeni detyruar të largoheni nga Kosova, mund të keni zotësi juridike të regjistroheshi për të votuar. Kur të aplikoni, luteni që të paraqitni dëshmi se jeni detyruar të largoheni nga Kosova.

SHEMBULL: Fotokopjen e dokumenteve zyrtare të refugjatëve. Me aplikacionin tuaj, luteni po ashtu të dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar të lëshuar në Kosovë e që ka datën dhe, nëse ka mundësi, adresën tuaj.

Shih: Pika 5, c.

OSE

e) Të jeni fëmijë në varësi nën moshën 18 vjeçare (por që mund t'i mbushni 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve) të personit të regjistruar në Regjistrin Civil në Kosovë

Nëse jeni nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, por do t'i mbushni 18 vjet përpara ose më 17 Tetor 2021 dhe vareni nga një person i cili është në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës, ju mund të aplikoni për të votuar. Luteni të dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar, me të cilin dëshmohet identiteti juaj (si në pikën 1 më lartë) së bashku me fotokopjen e një dokumenti zyrtar me të cilin dëshmohet identiteti dhe statusi i regjistrimit civil të prindit tuaj të regjistruar.

SHEMBULL: Dokumenti i identifikimi i prindit tuaj i lëshuar nga Republika e Kosovës/ UNMIK ose dëftesa e regjistrimit. Me aplikacionin tuaj, luteni po ashtu të dërgoni fotokopjen e një dokumenti zyrtar në të cilin tregohet lidhja juaj familjare me prindin tuaj.

SHEMBULL: Certifikata e lindjes, pasaporta e lëshuar nga ish – RFJ, letërnjoftimi i lëshuar nga ish – RFJ, etj.

SHËNIM: Ju duhet t'i mbushni 18 vjet deri me datën e zgjedhjeve, në mënyrë që të votoni në zgjedhje.

OSE

- f) Të jeni person në varësi nën moshën 23 vjeçare, i një personi të regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës dhe të jeni student i rregullt i një institucioni të njohur të arsimit.**

Nëse jeni nën moshën njëzet e tre (23) vjeçare dhe jeni i regjistruar në një institucion të njohur të arsimit dhe vareni nga personi i regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës, mund të aplikoni për të votuar. Luteni të dërgoni një fotokopje të një dokumenti zyrtar me të cilin ju dëshmohet identiteti (si në numrin 1 më lartë) së bashku me një fotokopje të një dokumenti zyrtar me të cilin dëshmohet identiteti dhe statusi i regjistrimit civil të prindit tuaj të regjistruar (shembull: dokumenti i identifikimit i prindit tuaj i lëshuar nga Republika e Kosovës/ UNIMK-u ose dëftesa e regjistrimit civil). Me aplikacionin tuaj luteni po ashtu që të dërgoni një fotokopje të një dokumenti zyrtar në të cilin tregohet lidhja juaj familjare me prindin tuaj (shembull: certifikata e lindjes, pasaporta e lëshuar nga ish – RFJ, letërnjoftimi i lëshuar nga ish-RFJ, etj.). Po ashtu duhet të dërgoni një fotokopje të një dokumenti zyrtar për të dëshmuar regjistrimin në studime të rregullta në një institucion të njohur të arsimit (shembull: dokumenti i identifikimit të studentit, dokumenti i regjistrimit, etj.).

III. Lista e dokumenteve dhe kushteve që përdoren si dëshmi për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike

Dokumenti	Identitetin*	Datën e lindjes	Komuna më 01/01/1998***	I lindur në Kosovë	Prindin të lindur në Kosovë	5 vite vendbanimin në Kosovë*	I dëbuar jashtë Kosovë	Fëmijë në varësi***	Fëmijë në varësi 18-23***
Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës	Po	Po		Po		Po			
Pasaporta e Republikës së Kosovës	Po	Po		Po		Po			
Patent Shoferi i Republikës së Kosovës	Po	Po		Po		Po			
Letërnjoftimi i UNMIK-ut	Po	Po		Po		Po			
Dokumenti i udhëtimit i UNMIK-ut	Po	Po		Po		Po			
Letërnjoftimi i RFJ-së	Po	Po	Po	Po		Po			
Pasaporta e RFJ-së (e vjetra dhe e reja)	Po	Po	Po	Po		Po			
Patentë shoferi i RFJ-së	Po	Po	Po	Po		Po			
Indeksi i universitetit	Po	Po		Po		Po			Po
Libreza ushtarake e RFJ-së	Po	Po	Po	Po		Po			
Letërnjoftimi i një vendi të huaj	Po	Po		Po					
Pasaporta e një vendi të huaj	Po	Po		Po					
Patentë shoferi i një vendi të huaj	Po	Po		Po					
Kartela zyrtare e refugjatit	Po	Po		Po	3		Po		
Dokumenti zyrtar i udhëtimit i refugjatit (me fotografi)	Po	Po	Po nëse paraqitet****	Po			Po		
Kartela e PZHBV-së, e Republikës së Serbisë	Po me/2**	Po	Po	Po					

Kartela e PZHbV-së, e Republikës së Malit të Zi	Po me/2	Po	Po	Po			Po		
Kartela e anëtar. e RFJ-së për personelin rezervë të UJ-së	Po me/3	Po		Po			Po		
Kartela e RFJ-së për person. e pensionuar/rezervë të APJ-së	Po me/4	Po		Po					
Libreza shëndetësore e RFJ-së (e vjetra - e gjelbër)		Po	Po	Po		Po			
Libreza shëndetësore e RFJ-së (e reja - e verdhë)		Po	Po	Po		Po			
Libreza shëndetësore e RFJ-së për bujq (e vjetra)		Po	Po	Po		Po			
Libreza ushtarake e RFJ-së	Po me/2	Po	Po	Po		Po			
Certifikata e lindjes e RFJ-së		Po	Po	Po	Po	Po		Po	Po
Certifikata e martesës e RFJ-së		Po	Po	Po		Po			
Certifikata e nënshtetësisë e RFJ-së		Po	Po, nëse paraqitet	Po		Po, nëse paraqitet			
Libreza e punës e RFJ-së		Po	Po	Po		Po			
Libreza e anëtarësisë së pensionistëve të RFJ-së		Po	Po			Po			
Libreza e shkollës fillore e RFJ-së	Po me/2, nëse ka foto	Po	Po	Po		Po			
Regjistrimi i automjeteve i RFJ-së (i vjetri)			Po			Po			
Regjistrimi i automjeteve i RFJ-së (i ri)			Po			Po			
Certifikata e lindjes e UNMIK-ut		Po		Po					
Certifikata e martesës e UNMIK-ut		Po		Po					
Certifikata e nënshtetësisë e UNMIK-ut		Po		Po					

Certifikata e statusit martesor e UNMIK-ut		Po		Po					
Fatura e rrymës elektrike (e vjetra)			Po			Po			
Fatura e rrymës elektrike (e reja)						Po			
Fatura telefonit (e vjetra)			Po			Po			
Fatura telefonit (e reja)						Po			
Fatura e ujit (e vjetra)			Po			Po			
Fatura e ujit (e reja)						Po			
Dëftesa e pensionit			Po			Po			
Libreza e kursimeve të postës		Po	Po	Po		Po			
Libreza e kursimeve të bankës		Po, nëse paraqitet	Po			Po			
Kartela e bankës, dëftesa e bankës			Po			Po			
Kartela e papunësisë			Po			Po			
Libreza e dhuruesve të gjakut e RFJ-së						Po			
Libreza sanitare e RFJ-së (për personelin mjekësor)	Po me/2	Po	Po	Po		Po			
Kartela e transportit publik të RFJ-së	Po me/3		Po			Po			
Kartela e anëtar. e shoqatës së gjuetarëve të RFJ-së	Po me/4	Po	Po	Po		Po			
Kartela e anëtar. e shoqatës së peshkatarëve të RFJ-së		Po		Po		Po			
Libreza e anëtar. e shoqatës së invalidëve të RFJ-së	Po me/2								
Leja e peshkimit e RFJ-së			Po			Po			
Kartela e anëtar. e shoqatës së vëzhguesve të Jugosllavisë	Po me/2	Po	Po	Po		Po			
Leja e armës e RFJ-së		Po	Po	Po		Po			

Kartela e anëtar. së shoqatës së futbollit të Jugosllavisë		Po	Po	Po		Po			
Kartela e vaksinimit e RFJ-së		Po	Po	Po		Po			
Marrëveshjet për blerje të shtëpive dhe marrje të tyre me qira					Po				
Kuponat e pagesave					Po				
Të tjera (për shqyrtim nëse janë të mjaftueshme)									

* Dokumenti duhet të ketë fotografi me qëllim të dëshmimit të identitetit.

** Po me/2 (d.m.th. 'me dy') - për regjistrim fillestar, pranohet si dëshmi e identitetit kur mbështetet me një dokument tjetër të identitetit.

Për ndryshimin e të dhënave të votuesit, pranohet në vete si dëshmi e identitetit.

*** 1/1/98 vendbanimi dëshmohet me një dokument të përshtatshëm që tregon vendbanimin në një komunë të caktuar në Kosovë deri dy vite përpara dhe një vit pas 1/1/98 (që d.m.th. mes 1/1/96 dhe 1/1/99).

**** Dokumenti zyrtar i udhëtimit i refugjatit mund të dëshmojë vendbanimin në Kosovë më 1/1/98, por dëshmon vetëm komunën e vendbanimit nëse është cekur në mënyrë specifike.